



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:252572
Datë: 19.12.2024
Numri i dokumentit: 06623415

ARJ nr.269/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Delushe Halimi dhe Zenel Leku anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në çështjen juridike sipas padisë në konflikt administrativ së propozuesit-paditësit “2 .K” Sh.P.K. me seli në fshatin, S., Komuna e K., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fitim Shabani, avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me seli në P., me bazë juridike anulim i akteve administrative-vendimit Nr.5236/23 të datës 12.09.2023 (nr.prot. 23/1NS-V-14-TGJ-80) dhe Vendimit Nr.5236-3/23 të datës 27.09.2023, të të paditurës, me kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishikimin e vendimit të formës së prerë të parashtruar nga propozuesi-paditësi, kundër aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës ARJ.nr.129/2024, të datës 23.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 12 Dhjetor 2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishikimin e vendimit të formës së prerë, e parashtruar nga propozuesi-paditësi “2. K” Sh.P.K., me seli në fshatin “S”., Komuna e K., kundër aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës ARJ.nr.129/2024, të datës 23.09.2024.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës ARJ.nr.129/2024, të datës 23.09.2024, REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi-propozuesi, “2 K” Sh.P.K. me seli në fshatin “S”., Komuna e K., kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhomat e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Sh.II.nr.1047/24, të datës 24.05.2024.

Propozuesi-paditësi kundër aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ka parashtruar propozim për përsëritjen e procedurës, me arsyetimin se i njëjti është i kundërligjshëm dhe i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës, dhe të drejtës materiale ngase në votimin dhe këshillimin e lëndës ka marrë pjesë anëtar i kolegjit-gjyqtari N.B., përkundër faktik se në të

njëjtën ditë është pensionuar. Tutje thekson se, pretendimet e tij vërtetohen me shpalljen nga faqja zyrtare e Gjykatës Supreme, me të cilën gjyqtari N.B., nderohet me mirënjohje, me rastin e pensionimit të tij, të cilën edhe ja ka bashkangjitur propozimit-kërkesës së tij. Propozon që të: LEJOHET përsëritja e procedurës dhe lënda të kthehet në rigjykim sipas nenit 239 par.2 të LPK-së.

Gjykata Supreme në përputhje me nenin 53 të LKA-së, mbajti seancën, vlerësoi pretendimet e paraqitura në propozim, dhe vendosi të mos e hedh poshtë propozimin për përsëritje të procedurës por ta trajtoi si kërkesë për rishikim të procedurës konform nenit 55 të LKA-së, ngase ky ligj i ka përcaktuar në mënyrë të qartë dhe shprehimore mjetet e jashtëzakonshme juridike me të cilat palët e pakënaqura mund të atakojnë vendimet e instancave gjyqësore dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishikim të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Lidhur me pretendimin e propozuesit-paditësit se vendimi i kësaj gjykate, është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës pasi që në votim ka marrë pjesë gjyqtari i cili është pensionuar, kolegji i Gjykatës Supreme e refuzoi në tërësi si të pabazuar dhe të paqëndrueshëm. Me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.nr.334/2024 të datës 18.09.2024 (të publikuar në web-faqen zyrtare), gjyqtari N. B., është propozuar për lirim nga detyra për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me datë 24 shtator 2024. Mandati i gjyqtarit N.B , sipas fuqisë ligjore ka përfunduar me datë 24 shtator 2024 dhe jo me datë 23 shtator 2023, kur edhe është votuar nga kolegji në përbërje Ragip Namani kryetar i kolegjit, Nebojša Boričić dhe Muhamet Rexha anëtar dhe është marrë Aktvendimi, ARJ.Nr.129/2024, me të cilin REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi-propozuesi, "2 K"., Sh.P.K. me seli në fshatin "S"., Komuna e K., kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhomat e Shkallës së Dytë, Kom.Dh.Sh.II.nr.1047/24, të datës 24.05.2024.

Mbi këto arsye, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës vlerëson se pretendimet e propozuesit-paditësit janë të pabazuara dhe jo me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje, sepse vendimi i Gjykatës Supreme të cilin e konteston paditësi është i drejtë dhe ligjor dhe nuk është i përfshirë me shkelje procedurale apo të drejtës materiale.

Nga sa u parashtrua si më lartë dhe në bazë të nenit 55 dhe 58 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ nr.269/2024, me datë 12 Dhjetor 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani